



**Hapet Thirrja për Mobilitete (Bursa) Studentësh të UPT-së
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +
në Universitetin e Poitiers, Francë.**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Prodhim Menaxhimit, në Universitetin e Poitiers, Francë.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master i Shkencave për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

! **Master i shkencave** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave, "Inxhinieri Mekanike" në vitin e parë ose të dytë, në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.

Kohëzgjatja e bursave dhe numri total i studentëve:

Master i shkencave, një periudhë 1 vjeçare, Shtator 2022 – Shtator 2023, **3 studentë**.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master shkencor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash të studimeve Bachelor për studentët Master viti i parë dhe Listë notash të studimeve Master për studentët Master viti i dytë;
- Aplikuesit duhet të kenë mesatare të studimeve mbi 7.0.
- Letër Motivimi;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën franceze ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për gjuhën, duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj përpara afatit të nisjes (Shtator 2022).*

Afati për aplikim për studentët: deri më 20 Shkurt 2022



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
– Mobility for learners and staff –



Aplikimi kryhet pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Të interesuarit mund të drejtohen pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit, për të dorëzuar dokumentacionin përkatës. (Kontakti Dr. Ilo Bodi, email: ibodi@fim.edu.al)

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit mund të kontaktoni në email: zyraekarrieres@upt.al